



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 394/1 Prot.

Vlorë, më 18.02.2020

VENDIM

Nr. 63, datë 18.02.2020

**PËR
ÇELJEN E PROCEDURAVE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT INSTITUCIONAL
ZGJEDHOR (KIZ) NË UV**


Në zbatim të Urdhrit Ministres së MASR, znj. Besa Shahini, Nr. 8, datë 14. 01. 2020 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në IAL", të Urdhrit të Rektorit të Universitetit, Nr. 9, datë 03. 02. 2020 "Për fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, pikës **a** dhe **d** të nenit **6** të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.02.2020


VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e procedurave për ngritjen e Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ) në UV.
2. Të miratojë përbërjen e KIZ, nga 5 (pesë) anëtarë; 4 personel akademik, nga një për çdo fakultet dhe 1 student. Në rast se nuk ka kandidatë të paraqitur nga një fakultet, atëherë vijon lista më poshtë.
3. Të miratojë çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe sekretar të KIZ-it të UV si dhe njoftimin zyrtar me kriteret përkatëse, drejtuar personelit akademik dhe studentëve, në funksion të regjistrimit për vetëkandidim, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë periudhën kohore të pranimit të vetëkandidimeve e cila zgjat 5 (pesë) ditë pune, duke filluar nga data e nënshkrimit dhe shpalljes nga Kryetari i SA të këtij vendimi.
5. Vetëkandidimet dorëzohen në Zyrën e Arkivit Qendror të UV dhe administrohen nga sekretaria e SA.
6. Vendimi shpallet në *Web-in* e UV-së dhe i dërgohet personelit akademik, drejtuesve të njëjësive bazë dhe kryesore, si dhe Këshillit Studentor të UV, për njohje dhe zbatim.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____.02.2020

Lënda : Njoftim për vetëkandidim për anëtarë të Komisionit Institucional Zgjedhor

PERSONELIT AKADEMIK

NJËSIVE KRYESORE DHE BAZË

KËSHILLIT TË STUDENTËVE

Në zbatim të pikës *a* dhe *d* të nenit 6 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Urdhrit Nr. 9, datë 03. 02. 2020 "Për fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, të Rektorit të UV dhe Vendimit të SA nr. 63, date 18.02.2020, njoftohen anëtarët e stafit akademik të njësive kryesore dhe studentët e njësive kryesore të cilët janë të interesuar për të kandiduar si anëtarë të Komisionit të Institucional Zgjedhor (KIZ), se nga data 18.02.2020 deri më 24.02.2020, ora 16.00, duhet të paraqesin kërkesën për vetëkandidim pranë sekretarisë (Zyrës së Arkivit Qendror të UV) së UV.

Anëtari i Komisionit Institucional Zgjedhor nuk ka të drejtë të kandidojë për autoritet drejtues ose në organet drejtuese, të çdo niveli.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

